



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:094918

Datë: 26.11.2024

Numri i dokumentit: 06548549

KPPP.nr.1381/2024

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arben Toska, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Sharr Beteiligungs GmbH” ShPK me NUI 810304808 me seli në rrugën Lagja e Punëtorëve p.nr. në Elez Han, i cili përfaqësohet në bazë të prokurës nga avokati Dastid Pallaska me seli në rrugën Ali Pashë Tepelena, Ivy Residence nr. 12 në Prishtinë, kundër debitorit “Administrata Tatimore e Kosovës” me seli në rrugën Dëshmorët e Kombit p.nr. në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër urdhrit përmbartimor P.nr.814/2022 të datës 13.12.2022 të përmbartuesit privat Ruzhdi Hoxha me seli në Prizren, pas seancës së datës 19.11.2024 për shqyrtimin e validitetit të prapësimit, në të cilën morën pjesë të dy palët, me datë 26 nëntor 2024, mori këtë:

AKTVENDIM

- I. Refuzohet në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “Administrata Tatimore e Kosovës” me seli në Prishtinë, i ushtruar kundër urdhrit përmbartimor P.nr.814/2022 të datës 13.12.2022 të përmbartuesit privat Ruzhdi Hoxha me seli në Prizren.
- II. Mbetet në fuqi urdhri përmbartimor P.nr.814/2022 i datës 13.12.2022 i përmbartuesit privat Ruzhdi Hoxha me seli në Prizren.

ARSYETIM

Kreditori “Sharr Beteiligungs GmbH” ShPK me NUI 810304808 dhe të dhëna tjera si në hyrjen e këtij aktvendimi (këtu e tutje Kreditori) më 13.12.2022 ka parashtruar propozim për përmbartim (këtu e tutje Propozimi) në zyrën e përmbartuesit privat Ruzhdi Hoxha me seli në Prizren (këtu e tutje Përmbartuesi), me të cilin ka kërkuar që nga debitori “Administrata Tatimore e Kosovës” me të dhëna tjera si në hyrjen e këtij aktvendimi (këtu e tutje Debitorët) të realizoj kërkesën shumë prej 395,113.06€ me kamatëvonesë vjetore prej 8% nga data 16.12.2014 deri në pagesën definitive dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore. Propozimin për përmbartim ia kishte

bazuar në aktgjykimin A.nr. 2511/14 të datës 18.07.2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, të cilin në origjinal ia kishte bashkëngjitur Propozimit (këtu e tutje Aktgjykimi). Kreditori së bashku me Propozimin, i kishte dorëzuar edhe kopjen e aktgjykimit AA.nr.869/2019 të datës 31.01.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës; aktgjykimin ARJ.nr.29/2022 të datës 20.10.2022 të Gjykatë Supreme të Kosovës, dhe kërkesën për përbarim vullnetar me numër 07-06-888 të datës 03.03.2022 të Kreditorit për Debitorin

Përbaruesi më 13.12.2022 e ka nxjerrë urdhrin përbarimor P.nr.814/2022 me të cilin e ka lejuar në tërësi përbarimin sipas Propozimit (këtu e tutje Urdhri).

Debitori më 27.12.2022 ka parashtruar prapësim (këtu e tutje Prapësimi) duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin dhe i ka kërkuar gjykatës që ta anuloj atë. Ai në Prapësim kanë deklaruar se më 05.05.2022 ka bërë një raport të kontrollit, nëpërmjet të cilit i ka bërë ndryshimet e duhur përmes rekonstruktimit dhe rregullimit përfundimtar të shpenzimeve të interesit në pasqyrat e të ardhurave për TAK/2006-2008 në periudhën 03/2022 sipas pikës III të aktgjykimit. Sipas Debitorit, nga prerja e gjendjes në formë të kompensimit në raportin debi-kredi rezulton se tatimpaguesi të ketë detyrime tatimore ndaj tij, prandaj, ai konsideron, se e ka ekzekutuar aktgjykimin lëndor. Prapësimi ia ka bashkëngjitur disa njoftime për rivlerësim, raportin kontrollues të datës 05.05.2022 dhe disa dokumente tjera të tij në raport me Kreditorit lidhur me procedurën pas marrjes së formës së prerë të aktgjykimit lëndor. Nuk i ka kërkuar shpërblimin e shpenzimeve procedurale lidhur me paraqitjen e Prapësimi.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi Prapësimin dhe i ka kërkuar gjykatës që ta refuzoj atë. Ai ka deklaruar se Prapësimi është i palejueshëm, pasi nuk bazohet në nenin 71 të LPP-së, si bazë ekskluzive për paraqitjen e prapësimi, siç përcakton neni 69 para. 5 i LPP-së. Më tutje ka sqaruar se sipas Prapësimi, Debitori nuk mund t'i zbatoj aktgjykimet përmes rivlerësimit të detyrimeve tatimore. Përgjigjes në prapësim nuk i ka bashkëngjitur asnjë provë, si dhe nuk e ka kërkuar shpërblimin e shpenzimeve procedurale të shkaktuara në këtë gjykatë lidhur me paraqitjen e përgjigjes në prapësim përmes avokatit.

Pasi kjo gjykatë e kishte refuzuar Prapësimin, Dhoma e Shkallës së Dytë e kësaj gjykata duke e aprovuar ankesën e Debitorit, përmes aktvendimit K.Dh.Sh.II.nr.501/2024 të datës 05.06.2024 e kishte kthyer çështjen në rivendosje, duke e udhëzuar këtë gjykatë të vlerësoj se Debitori a e ka zbatuar aktgjykimin lëndor. Kjo gjykatë duke i zbatuar udhëzimet e instancës direkt më të lartë, caktoi seancën për shqyrtimin e validitetit të prapësimi, në të cilën morën pjesë të dy palët.

Në atë seancë Debitorit deklaroi se ai e ka ekzekutuar me përpikëri të plotë aktgjykimet e Gjykatës Komerciale me ç' rast gjatë procedurës së ekzekutimit të aktgjykimit është dashur të hapen llogaritë tatimore të biznesit në fjalë, andaj pas rregullimit të gjendjes apo të intervenimit në sistemin SIGDAS gjendja e tatimpaguesit ka ndryshuar si rezultat i prekjeve apo ndërhyrjeve të llogarive tatimore. Sipas tij, pas këtij intervenimit të ATK-së kemi një gjendje tjetër tatimore për shkak të reflektimit të obligimeve të dala nga kontrolli lidhur me ekzekutimin e aktgjykimit, prandaj drejtoria e tatimpaguesve të mëdhenj ka nxjerrë një raport kontrolli e cila e ka rregulluar gjendjen në sistem lidhur me obligimet tatimore fjala është për raportin e kontrollit të datës 05.05.2022 të cilën raport tatimpaguesi apo kreditori e ka kundërshtuar me ankesën e tij drejtuar divizionit të ankesave në ATK me ç' rast ky i fundit me vendimin me numër 249/22 të datës 22.07.2022. Më tutje ka sqaruar se, të njëjtin vendim Kreditori në procedurë administrative e ka kundërshtuar në gjykatë me datë 19.08.2022, që nënkupton se për çështjen e njëjtë për të cilën jemi këtu është duke u zhvilluar edhe një procedurë kontestimore lidhur me çështjen e njëjtë. Për fund ka shtuar se, pas ekzekutimit të aktgjykimit lëndor, Kreditorit i kanë lindur detyrimet: TAGCD2006-2009 WVR12/2006 12/2007 12/2008 dhe 3/2009, të cilat janë të sqaruara në raportin e kontrollit e të cilat detyrime të lindura nga vlera e rikthyer sipas aktgjykimit, Kreditori është dashur t'i paguaj në periudhën e lartcekur.

Kreditore gjatë seancës ka deklaruar se, objekt shqyrtimi në këtë procedurë përmbartimore është vendimi gjyqësor i formës së prerë, i cili është vërtetuar në tri instanca gjyqësore, si dhe dispozitivi i aktgjykimit është jashtëzakonisht i qartë dhe po që i thjeshtë, e detyron Debitorin që Kreditorit t'ia kthej/rimburoj shumën e akorduar me vendim gjyqësor. Në lidhje me këtë ka shtuar se, dispozitivit e vendimeve gjyqësore janë të qarta pikërisht për të shmangur situata që mund të krijojnë paqartësi gjatë përmbartimit të tyre, rrjedhimisht urdhrat e dhënë në dispozitiv të gjykatës nuk mund t'i nënshtrohen perspektivave subjektive të palëve ndërgjyqëse. Gjithashtu ka pretenduar se, Debitori nuk i ka kthyer/rimbursuar Kreditorit shumën e akorduar aktgjykimin e formës së prerë dhe kjo është edhe arsyeja pse Debitori, përkundër detyrimit për të prezantuar prova për përmbartimin e aktgjykimin sipas nenit 69.4 të LPP-së, nuk e ka dorëzuar asnjë provë të vetme që vërteton pagesën e shumës që gjykata ia ka akorduar kreditorit. Sipas tij, vetëm mbi këtë bazë Prapësimi duhet të refuzohet në tërësi.

Përveç kësaj, Kreditore ka deklaruar se, Debitori jo vetëm që ka përmbysur vendimin e gjykatës i cili është objekt i kësaj procedure përmbartimore, por edhe në parashtrimet e veta me shkrim dhe në seancën e sotme përbuzë gjykatën dhe kreditorin me deklaratimet se kinse këta të fundit nuk po i kuptuakan procedurat e brendshme të debitorit për përmbartimin e vendimit gjyqësor.

Më tutje ka argumentuar se, ndryshe nga ç' pretendon Debitori, ATK ka procedura për përmbartimin e drejtpërdrejtë gjyqësore të formës së prerë, të cilat i mundësojnë ATK-së ndërhyrjet e drejtpërdrejta në sistem me qëllim të realizimit të pagesave për kthimin e tatimeve të arkëtuara në mënyrë të kundërligjshme, një ndër këto procedura është formulari i debitorit AU 011 me të cilin vlera që duhet t'i kthehet një tatimpaguesi sipas një vendimi gjyqësor përfshihet direkt në sistem. Për më tepër, sipas tij, Debitori jo vetëm që nuk e ka përdorur këtë procedurë por edhe deri më tani ia ka fshehtë gjykatës ekzistimin e kësaj procedure në deklaratimet e saja me shkrim. Më tutje ka shtuar se, në asnjë prej komunikimeve që e ka pasur me përfaqësuesit e departamentit për tatimpaguesi e mëdhenj të Debitorit, këta të fundit nuk e kanë njoftuar atë se e kanë përmbushur aktgjykimin lëndor, gjë që dëshmon se edhe vetë Debitori është i vetëdijshëm se nuk e ka përmbushur aktgjykimin lëndor. Për fund ka shtuar se, pretendim i Debitorit se i ka bërë thyerje të kërkesave borxheve është i pavërtetë dhe ky fakt vërtetohet edhe me vendimin e divizionit të ankesave në lidhje me këtë raport të ri kontrollit faqe 6 par. 3 i cili shprehimisht thotë se njoftim rivlerësimet që kanë rrjedhur nga ky raport i ri kontrollit “nuk pasqyrojnë gjendjen reale të tatimpaguesit”. As gjatë seancës nuk e ka kërkuar shpërblimin e shpenzimeve procedurale.

Gjykata me qëllim që ta zbatoj udhëzimin e instancës së shkallës së dytë gjyqësore, në bazë të nenit 403.3 të LPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së, gjatë seancës së shqyrtimit të validitetit të prapësimi kërkoj sqarime nga Debitori lidhur me faktin se, shuma e kërkuar në përmbartim a është transferuar në xhirollogarinë e kreditorit para fillimit ose gjatë zhvillimit të kësaj procedure përmbartimore. Në lidhje me këtë, Debitori sqaroi se pasi ka pranuar aktgjykimin lëndor ATK për të ekzekutuar në përpikëri aktgjykimin është procedurë institucionale e ndërlidhur me programin tatimor që në momentin e veprimit sipas aktgjykimit dhe rikthimin e obligimit sipas gjykatës në vlerën e kërkuar kreditorit i kanë lind detyrime për periudhat tatimore dhe llojit e tatimeve dhe vlera për kthim sipas aktgjykimit është thyer me obligimet tatimore të cilat kanë lindur pas intervenimit të këtij aktgjykimit, pra është e pamundshme që shuma e kërkuar të transferohet tek kreditori.

Pas shqyrtimit të pretendimeve të palëve të paraqitura në parashtrësat e tyre dhe gjatë seancës, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimi të provave që gjenden në shkresat e lëndës, gjykata gjeti se prapësimi është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal përmes aktgjykimit A.nr.2411/14 të datës 18.07.2019 në pikën III. të dispozitivit e ka detyruar Debitorin që t'ia kthej Kreditorit shumën prej 395,113.06€ me

kamatëvonesë prej 8% duke filluar nga data 16.12.2014 deri në pagesën definitive. Edhe pse detyrimi për kamatëvonesën është ndryshuar me vendimin e shkallës së dytë, megjithatë Gjykata Supreme e Kosovës përmes aktgjykimit ARJ.nr.29/2022 të datës 20.10.2022 ka gjykua se Debitori si i paditur duhet t'ia paguaj Kreditorit si paditës kamatëvonesën prej 8% në vit duke filluar nga data 16.12.2014.

Aktgjykimi është i ekzekutueshëm nga data 15.11.2022, siç rrjedhë nga klauzola e përmbareshmërisë e paraqitur në formë të vulës.

Në shkresa të lëndës nuk gjendet ndonjë provë se Aktgjykimi është anuluar, është ndaluar ekzekutimi i tij ose në ndonjë formë është shpallur i pavlefshëm. Gjithashtu në shkrësat e lëndës nuk ka prova se Debitori e ka paguar pjesërisht ose tërësisht detyrimin që rrjedhë nga Aktgjykimi (e ka rimbursuar-kthyer Kreditorit shumën e caktuar në Aktgjykim), ose se detyrimi është shuar në mënyrë të ligjshme.

Situata e lartcekur rregullohet me nenin 22 të LPP-së, i cili në para. 1 nënpara. 2 ka rregulluar se dokumente përmbareshme janë “(...) vendimi përmbaresh i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbaresh”. Gjithashtu nenit 23 para. 1 i LPP-së ka përcaktuar se “Sipas këtij ligji, vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi, si dhe vendimi tjetër i dhënë në procedurën gjyqësore ose të arbitrazhit, kurse ujdi gjyqësor konsiderohet ujdia e arritur përpara Gjykatës dhe arbitrazhit si dhe marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit”, kurse neni 24 para. 1 i LPP-së ka paraparë se “Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje, është i përmbareshëm po që se ka marrë formë të prerë, si dhe po që se ka skaduar afati për përmbushje vullnetare”. Në anën tjetër, neni 27 para. 1 ka paraparë se “Dokumenti përmbaresh është i përshtatshëm për përmbaresh në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”

Nga këto dispozita rrjedhë se, përmbareshi mund të fillohet në bazë të vendimit të dhënë në procedurë gjyqësore nëse është bërë i formës së prerë dhe ka kaluar koha e përmbushjes vullnetare, si dhe e ka përmbajtjen e caktuar me LPP. Në rastin konkret janë plotësuar të gjitha këto kushte, meqenëse Aktgjykimi është i formës së prerë dhe ka kaluar koha e përmbushjes vullnetare, pra është bërë i ekzekutueshëm, si dhe përmban të dhëna për palët, llojin dhe shumën e detyrimit dhe kohën e përmbushjes së detyrimit, rrjedhimisht i plotëson të gjitha kushtet për të qenë dokument përmbaresh dhe për të lejuar përmbareshin në bazë të tij.

Gjykata e vlerëson si të pabazuar pretendimin e Debitorit se e ka përmbushur detyrimin që rrjedhë nga Aktgjykimi. Rikujtojmë se, me Aktgjykim ai ishte detyruar që ta përmbush një

detyrim në të holla. Sipas nenit 288 [Përmbajtja e përmbushjes] të LMD-së “1. Përmbushja përbëhet nga kryerja e asaj që është përmbajtja e detyrimit, ashtu që as debitori nuk mund ta përmbush me diçka tjetër dhe as kreditori nuk mund të kërkojë diçka tjetër. 2. Përmbushja nuk është e vlefshme, në qoftë se ajo që debitori e ka dorëzuar si send borxh dhe kreditori e ka pranuar si të tillë, gjë që në të vërtetë nuk është dhe kreditori ka të drejtë ta kthejë atë që i është dorëzuar dhe të kërkojë sendin borxh.”, ndërsa sipas nenit 289 [Zëvendësimi i përmbushjes] të LMD-së “1. Detyrimi shuhet në qoftë se kreditori në marrëveshje me debitorin pranon diçka tjetër në vend të asaj që ka borxh. 2. Në atë rast debitori përgjigjet sikurse shitësi për të metat materiale dhe juridike të sendit të dhënë në vend të asaj që ka borxh. 3. Megjithatë, kreditori në vend të kërkesës në bazë të përgjegjësisë së debitorit për të metat materiale ose juridike të sendit mund të kërkojë nga debitori, por jo më nga dorëzani, përmbushjen e kërkesës paraprake dhe dëmshpërblimin”. Në anën tjetër, Ligji nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, me ndryshimet e pësuara përmes ligjit 04/L-102 dhe 04/L-223, në asnjë dispozitë nuk e ka paraparë të drejtën e ATK-së, pra Debitorit, që pa pëlqimin e Kreditorit ta zëvendësoj ose kompensoj përmbushjen e detyrimit të caktuara me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Nga këto dispozita rrjedh se, debitori e ka për obligim që ta përmbush detyrimin përmes kryerjes së përmbajtjes së detyrimit, ndërsa nuk mundet të zëvendësoj përmbajtjen e përmbushjes me diçka tjetër, përderisa nuk është marr vesh me kreditorin për zëvendësimin e përmbushjes. Në rastin konkret, sipas Aktgjykimit, Debitori ka qenë i detyruar që t’ia rimburosj-t’ia kthejë Kreditorit shumën e të hollave prej 395,113.06€ së bashku me kamatëvonesën prej 8% nga data 16.12.2014, rrjedhimisht ky detyrimin do të ishte përmbushur përmbushet vetëm nëse Debitori do t’ia ia kishte dorëzuar Kreditorit shumën në fjalë. Meqenëse nuk ka ndodhur kjo, siç ka deklaruar përfaqësuesja e Debitorit gjatë seancës, atëherë gjykata, duke e zbatuar udhëzimin e Gjykatës Komerciale, Dhoma e Shkallës së Dytë, vjen në përfundimin se Debitori qartazi nuk e ka përmbushur detyrimin e tij që rrjedh nga Aktgjykimi.

Gjykata e sheh të rëndësishme të sqaroj se, çështjet tjera fiskale që i kanë ndërgjyqësit nuk ishin dhe nuk mund të jenë objekt i kësaj procedure përbarimore, rrjedhimisht ato duhet të trajtohen në procedura të veçanta administrative ose gjyqësore. Gjithashtu, çështjet e brendshme të Debitorit lidhur me sistemin e përmbushjes së detyrimeve të tij i përkasin vet Debitorit dhe ai vet duhet të gjej zgjidhjen e duhur për përmbushjen e detyrimeve të caktuara nga gjykata, ndërsa palët nuk mund të privohen nga e drejta për ekzekutimin e vendimit gjyqësor (siguria juridike), për shkak të rregullimit të brendshëm të Debitorit.

Gjithashtu, Debitori nuk ka paraqitur asnjë provë me të cilën do të provoheshin rrethanat nga neni 71 i LPP-së, ashtu siç e ka obliguar neni 69 para. 4 i LPP-së, sipas të cilit “*Baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet*”. Gjykata i mori parasysh edhe pretendimet tjera si të Kreditorit ashtu edhe Debitorit, megjithatë ato nuk kishin rëndësi për të vendosur ndryshe.

Gjykata gjithashtu e bëri shqyrtimin e ligjshmërisë së Propozimit dhe Urdhrit dhe gjeti se ata janë hartuar sipas kërkesave ligjore të LPP-së, ashtu që i përmbajnë të dhënat për palët, për dokumentin e përmbarimor, objektin dhe mjetet e përmbarimit, si dhe janë caktuar kufijtë e përmbarimit në përputhje me dokumentet përmbarimore, siç rregullojnë nenet 36 paragrafi 1, 38 paragrafi 1, 43 dhe 49 të LPP-së.

Për këto arsye, në kuptim të nenit 73 para. 3 të LPP-së lidhur me nenin 13 para.1 nën para. 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi

Gjykata Komerciale e Kosovës
Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike
KPPP.nr.1381/2024

Gjyqtari

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga dita e pranimit. Ankesa në formë të shkruar dhe në ekzemplarë të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale.